



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE  
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

**MINISTRI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET  
VENDORE**

Nr. 5335 Prot. Datë 24.12.2015

Nr. 6434 Prot. Datë 29.12.2015

## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**Për përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurimin e të Dhënave mbi  
Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara**

Nisur nga vullneti i përbashkët institucional për të kontribuar në mbledhjen dhe raportimin e statistikave të harmonizuara për rastet e korrupsionit dhe krijimin e një historiku solid rezultatesh dhe zbatimin me efektivitet të masave nën Prioritetin 3 të Bashkimit Europian për Shqipërinë;

*Në kuadër të:*

- Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara si bazë të dhënash shtetërore krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 7.10.2015;
- Monitorimit dhe analizës së të dhënave të rasteve të korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të institucioneve ligjzbatuese të masave kundër korrupsionit;

*Me synim:*

- Analizimin e prirjeve të korrupsionit dhe efektivitetit të masave kundër korrupsionit nëpërmjet shqyrtimin të një sistemi të unifikuar dhe kompjuterizuar të mbledhjes së të dhënave për rastet e korrupsionit; si dhe
- Rritjen e bashkëpunimi ndër-institucional;

*Në zbatim të:*

- Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10325/2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1012, datë 22.11.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore”
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.3.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 28.5.2014 “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 7.10.2015, “Për Krijimin, Administrimin dhe Përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara”;

Palët bien dakord sa më poshtë:

## **Neni 1**

### **Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi dhe koordinimi mes Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave elektronike mbi kallëzimet e veprave penale të korrupsionit me qëllim krijimin e një historiku solid dhe gjurmimin e rasteve të korrupsionit të funksionarëve shtetëror, si dhe gjenerimin e statistikave të harmonizuara.

## **Neni 2**

### **Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara**

- 2.1 Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara (në vijim “*Sistemi*”) është sistemi i grumbullimit të të dhënave elektronike nëpërmjet formatit *web-based* nga institucionet shtetërore në lidhje me veprat penale të korrupsionit të funksionarëve shtetëror.
- 2.2 ILDKPKI hedh, grumbullon dhe përditëson të dhëna mbi kallëzimet lidhur me veprat penale të korrupsionit ndaj funksionarëve publik në përputhje me fushën e saj të kompetencës dhe sipas kësaj Marrëveshjeje. Modulet dhe lloji i informacionit që do të hedhin në sistem përdoruesit përcaktohen në Shtojcën 1 bashkëlidhur.
- 2.3 Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, është administratori i Sistemit për të gjithë përdoruesit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 7.10.2015.
- 2.4 ILDKPKI do të ketë akses të plotë dhe të pakufizuar mbi të gjitha të dhënat e hedhura nëpërmjet llogarisë së saj në Sistem.
- 2.5 ILDKPKI, me kërkesë drejtuar Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, do të ketë akses tek statistikave të harmonizuara të gjeneruara nga Sistemi.

### **Neni 3**

#### **Detyrime të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore**

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në cilësinë e Koordinatorit të Sistemit, angazhohet dhe merr përsipër sa më poshtë:

- 3.1 Të vendosë në dispozicion të ILDKPKI programin kompjuterik në formatin *web-based* të Sistemit, i aksesueshëm nëpërmjet llogarisë së veçantë të ILDKPKI dhe hostuar rregullisht nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- 3.2 Të zhvillojë trajnime dhe udhëzojë ILDKPKI mbi mënyrën dhe modalitetet përdorimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit, si dhe të përgjigjet në çdo kohë në lidhje me kërkesa të veçanta të Përdoruesve;
- 3.3 Të sigurojë që Sistemi të gjenerojë në çdo kohë raporte statistikore;

### **Neni 4**

#### **Detyrime të ILDKPKI**

- 4.1 ILDKPKI angazhohet se brenda fushës së saj të kompetencës do të marrë të gjitha masat ligjore, strukturore dhe teknike për hedhjen e të dhënave në Sistem nga ILDKPKI sipas Formularit në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje.
- 4.2 ILDKPKI do të monitorojë zbatimin dhe përdorimin e pandërprerë të Sistemit dhe do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të garantuar:
  - a. saktësinë e të dhënave të hedhura në Sistem;
  - b. hedhjen dhe përditësimin e të dhënave në kohë reale brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga depozitimi i njoftimit/kallëzimit me të dhënat e kërkuara sipas Formularit të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje.
- 4.3 ILDKPKI do të mirëmbajë në çdo kohë Sistemin sipas parametrave teknike/elektronike të udhëzuara nga Koordinatorin e Sistemit dhe se do të kërkojë asistencë të specializuar brenda një kohe të përshtatshme për të garantuar funksionimin optimal të Sistemit në çdo kohë.
- 4.4 ILDKPKI do të njoftojë Koordinatorin e Sistemit për çdo shqetësim, sugjerim apo kërkesë e cila kërkon ndërhyrjen e menjëhershme të Koordinatorit në lidhje me përdorimin e Sistemit, si dhe të shkëmbejë me Koordinatorin e Sistemit informacionin e nevojshëm të përcjellë nga strukturat institucionale në varësi të saj.

### **Neni 5**

#### **Koordinimi ndërmjet Palëve dhe përdoruesit e Sistemit**


- 5.1 ILDKPKI do të caktojë një ose më shumë persona përgjegjës të cilët do jenë përdoruesit e Sistemit për ILDKPKI, do të kenë akses të drejtpërdrejtë në llogarinë e ILDKPKI në Sistem, do të hedhin të dhënat e kërkuara dhe do të koordinojnë punën me titullarin e institucionit dhe zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.
- 5.2 ILDKPKI njofton me shkrim zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit personin/at përdorues të Sistemit për ILDKPKI brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje.

**Neni 6**  
**Dispozita të fundit**

- 6.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet për një afat të pacaktuar.
- 6.2 ILDKPKI do të hedhë të dhëna sipas Formularit në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje duke filluar nga data 1 qershor 2014.
- 6.3 Palët do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshje. Komunikimi në çdo rast do të jetë në formë shkresore.
- 6.4 Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje dhe secila palë mban nga një kopje të njëjtë.

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE  
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Shkëlqim GANAJ



**PËR MINISTRIN E SHTETIT PËR  
ÇËSHTJET VENDORE**

Bledar ÇUÇI





**Koordinatori Kombëtar  
Kundër Korrupsionit**

**Raportim i Njoftimit/Kallëzimit në Prokurori**

**1) Të dhëna bazë**      Institucioni kallëzues:

Prokuroria ku bëhet Kallëzimi:

Numri dhe Data e Protokollit të Kallëzimit:

**2) Personat e Kallëzuar**      Numri i të Kallëzuarve:

Kodi i Pozicionit 1: <input type="text"/>	Kodi i Pozicionit 5: <input type="text"/>
Kodi i Pozicionit 2: <input type="text"/>	Kodi i Pozicionit 6: <input type="text"/>
Kodi i Pozicionit 3: <input type="text"/>	Kodi i Pozicionit 7: <input type="text"/>
Kodi i Pozicionit 4: <input type="text"/>	Kodi i Pozicionit 8: <input type="text"/>

**3) Nenet e Korrupsionit**

<input type="checkbox"/> Neni 135	<input type="checkbox"/> Neni 256	<input type="checkbox"/> Neni 319
<input type="checkbox"/> Neni 164/a	<input type="checkbox"/> Neni 257	<input type="checkbox"/> Neni 319/a
<input type="checkbox"/> Neni 164/b	<input type="checkbox"/> Neni 257/a	<input type="checkbox"/> Neni 319/b
<input type="checkbox"/> Neni 244	<input type="checkbox"/> Neni 258	<input type="checkbox"/> Neni 319/c
<input type="checkbox"/> Neni 244/a	<input type="checkbox"/> Neni 259	<input type="checkbox"/> Neni 319/ç
<input type="checkbox"/> Neni 245	<input type="checkbox"/> Neni 259/a	<input type="checkbox"/> Neni 319/d
<input type="checkbox"/> Neni 245/1	<input type="checkbox"/> Neni 260	<input type="checkbox"/> Neni 319/dh
<input type="checkbox"/> Neni 248	<input type="checkbox"/> Neni 312	<input type="checkbox"/> Neni 319/e

Nuk janë specifikuar nenet që e klasifikojnë si rast korrupsioni.

Data:

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi